

KONTRATE SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(Lloji kuota)

Sot me date 23.03.2020 ne palet e meposhtme redaktojme kete kontrate si me poshte vijon:

PALA shitese:

1. **Z. SUAD CELAJ**, i biri i Agim dhe Lindita, i datëlindjes 19.09.1994, lindur ne Fier dhe banues ne Fier , madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, i identifikuar nepermjet leternjoftimit Nr. 030860451 dhe me numer personal : J40919023M ne cilesine e ortakut te vetem te shoqerise.

PALA blerese:

Znj. ARDITA DUMI, e bija FAIK dhe HILMIE , i datëlindjes 08.07.1989, lindur ne Fier, dhe banuese ne Fier, Rruga " Jakov Xoxa", madhore dhe me zotesi te plote per te vepruar, me numer personal I95708109F .

Të përgjithshme

1. Shitesi është zotërues i 50(pesedhjete) kuotave, me vlere 50.000 (Pesedhjete mije)Lek, qe perben **50(pesedhjete)** % te kapitalit të Shoqërisë "CONTACT GREI" shpk, me seli ne TIRANE, Rruga "Shemsi Haka" ,Zona kadastrale Nr.8180, nr. Pasurie 6/682-N3. (më poshtë referuar si shoqëria.)
2. Shoqëria është rregjistruar pranë QKR-se si shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, e pajisur me **NUIS M01428017A** me objekt kryesor "Sherbime Telefonike Call CENTER."
3. Kapitali i shoqërisë është 100.000 (Njeqind mije) lek.
4. Shoqëria "CONTACT GREI" Sh.p.k zotërohet nga dy ortake:
 - a. Znj. ARDITA DUMI, e cila zoteron 50(pesedhjete) kuota qe perbejne 50% te kapitalit themeltar.
 - b. Z. SUAD CELAJ, i cili zotëron 50(pesedhjete) kuota qe perbejne 50% te kapitalit themeltar.

Neni 1

Objekti

Në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë kontrate, Shitesi i kalon bleresit 50 % të kapitalit të zotëruar në kete shoqëri si dhe të drejtat e tjera të lidhura me këtë pjesëmarrje duke e garantuar plotësisht per titullin e pronësisë.

Neni 2

Kalimi i pronësisë mbi kuotat

Kalimi i pronësisë mbi kuotaen do të kryhet menjëherë me nënshkrimin e kontratës.

Neni 3

Garancitë

Shitesi në lidhje me kuoten që zotëron, garanton bleresin se :

1. Është pronar i vetem i kuotes.
2. Në të njëjtën kohë garanton dhe siguron palën blerese se sot në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate kuota eshte e lire nga çdo barrë, marrëveshje apo vendim tjetër kufizues;

- Nuk është objekt i ndonjë konflikti gjyqësor;
- Eshtë e lire nga çdo e drejtë apo pretendim i personave të tretë;

Neni 4

Ligji i zbatueshëm

Kjo kontratë rregullohet nga ligji nr. 9901 date 14.04.2008 “Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, Ligji “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” si dhe dispozitat e aktit të themelimit dhe Statutit të Shoqërisë.

Neni 5

Regjistrimi

- Kjo kontratë duhet të regjistrohet pranë QKR-së në bazë të nenit 43 të ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, i ndryshuar. Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.
- Pas nënshkrimit të kësaj kontrate shoqëria “CONTACT GREI” Sh.p.k do të jete ne pronesi te plote te pales blerese, pra Znj. Ardita Dumi.
- Personi që kalon kuotat dhe ai që i fiton ato, përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotave, nga Çasti i kalimit të kuotave deri në Çastin e regjistrimit të kalimit sipas dispozitave në fuqi.

Neni 6

Shpenzimet

Të gjitha taksat, tatimet si dhe shpenzimet që kanë lidhje me këtë kontratë do të paguhen nga pala përkatëse sipas parashikimeve të legjislacionit shqiptar. Palët në këtë kontratë nuk mund ti kërkojnë njëra tjetrës uljen/ngritjen e çmimit të shitjes për shkak të shpenzimeve të sipërpëmendura.

Neni 7

Interpretimi i Kontratës

Çdo kusht apo formulim që mund të shkaktojë paqartësi do të interpretohet në kontekstin e tërësisë së kontratës dhe në këndvështrimin e qëllimit që i shtyu palët në lidhjen e kësaj kontrate.

Për çfarë nuk është parashikuar në këtë kontratë, do të zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar në fuqi.

Neni 8

Njoftimi zyrtar midis palëve

Çdo njoftim, kërkesë apo komunikim ndërmje palëve do të bëhet në formë të shkruar dhe në adresat e përshkruara në këtë kontratë.

Neni 9

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë nga interpretimi apo zbatimi i kushteve të kësaj kontrate, do të zgjidhet me bisedim dhe mirëkuptim të ndërsjellë midis palëve dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, në të kundërt kompetente për zgjidhjen e konfliktit do të jete *Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane*.


Neni 10

Hartimi i Kontratës

Kjo kontratë hartohet në kater njësi origjinale të cilat kanë të njëjtën përmbajtje dhe vlerë ligjore, prej të cilave nga 3 njësi i mbajnë palët dhe një njësi depozitohet pranë QKR-së .

Ne Palët deklarojme se kuptojme dhe se e pranojnë këtë kontratë, pasi ajo është në përputhje me vullnetin tone të lirë dhe të plotë dhe e nënshkruajmë atë rregullisht.

PALET KONTRAKTUESE

Juad Gelyj


Araila Suman
